

VENDIM
Nr. 71, datë 23.1.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT SUEDEZ NR. TF012392, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), E CILA VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA SUEDIA, PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË TOKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit suedez nr. TF012392, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), e cila vepron si administratore e fondeve grant të siguruar nga Suedia, për bashkëfinancimin e projektit të menaxhimit dhe administrimit të tokës, nëpërmjet një granti prej 18 711 000 SEK (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë korona suedeze)”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha